

FAKULTETI I DREJTËSISË

**RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT
MASTER I SHKENCAVE "E DREJTË BIZNESI"**

**KREU I
PARIMET E PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Baza ligjore**

Rregullorja mësimore e programit të studimit Master i Shkencave e Drejtë Biznesi mbështetet në Ligjit 80/2015 datë 22. 07. 2015. "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Statutin si dhe Rregulloren e Përgjithshme të TBU.

**Neni 2
Objekti**

Kjo rregullore vendos rregullat normative për organizimin dhe funksionimin e programit të studimit Master i Shkencave "E Drejtë Biznesi" me 120 ECTS dhe të marrëdhënieve që krijohen midis subjekteve pjesëmarrëse në zhvillimin e këtij programi.

Ajo është hartuar në përputhje me planin mësimor të programit, duke respektuar legjislacionin në fuqi, lirinë akademike, të drejtat dhe detyrimet e personelit akademik dhe të studentëve.

Çdo aspekt tjetër që nuk është trajtuar në këtë rregullore do të trajtohet ashtu si përcaktohet në Rregulloren e Përgjithshme dhe Statutin e TBU-së.

**KREU II
ELEMENTËT E PROGRAMIT MËSIMOR**

**Neni 3
Misioni dhe objektivat e Diplomës**

Qëllimi i këtij programi është të përgatisë juristë të aftë që të operojnë në fushën e Business Law me njohuri të plotësuara shkencore në fushën juridike dhe ekonomike, të cilët janë të formuar rigorozisht dhe të pajisur mirë me të gjitha aftësitë juridike për të analizuar dhe zgjidhur çështje komplekse të kompanive ne situata të ndryshme, nga perspektiva e të drejtës së biznesit dhe marrëdhëniet ekonomike të tij.

Objektivat e programit Master i Shkencave "E Drejtë Biznesi" me 120 ECTS janë:



- Studentët kanë njohuri të thella mbi legjislacionin dhe mbi biznesin dhe janë në gjendje për të vendosur lidhje ndërdisiplinore.
- Studentët janë të aftë të lidhin zgjidhjen e një çështje gjyqësore që ka të bëjë me veprimtarinë e firmave dhe probleme ekonomike.
- Studentët janë në gjendje të mbledhin, përzgjedhin, vlerësojnë dhe interpretojnë normat ligjore për zgjidhjen e problemeve me natyrë juridike shkencore, në mënyrë që të arrijë në një vlerësim kompetent të parë nga këndvështrimi juridik, ekonomik dhe ai i korporatave.
- Studentët janë të aftë për të përpiluar shkresa të ndryshme në mënyrë të përmbledhur.
- Studentët janë të aftë për të paraqitur problemet gjyqësore me gojë.
- Studentët janë të aftë të përpilojnë aktet ligjore që lidhen me fushën e biznesit, kontrata, kërkesa drejtuar organeve administrative dhe gjyqësore, etj.

Neni 4

Programi i Studimit

- a) Programi i studimit Master i Shkencave "E Drejtë Biznesi", është program i ciklit të dytë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike dhe me 120 kredite (ECTS). Forma e studimit është me kohë të plotë dhe të zgjatur.
- b) Programi mësimor është parashikuar të realizohet në 3.000 orë, nga të cilat 1005 orë janë orë studimi në auditor dhe 1995 janë orë studimi individual.
- c) Procesi mësimor është organizuar në dy vite akademik, gjatë të cilit studenti fiton 120 kredite (ECTS). Viti akademik zgjat 30 javë mësimore dhe 4 javë të parashikuara për sesionet normale të provimeve. Studenti zhvillon mesatarisht 20 orë mësimorë në javë në auditor.
- d) Koha e fillimit, mbarimit, sesionet e provimeve, pushimet e festave zyrtare përcaktohen në kalendarin akademik të miratuar nga senati në fillim të çdo viti akademik.

Neni 5

Struktura e programit mësimor

Studenti që ndjek këtë program studimi duhet të përfitojë të paktën 120 kredite, nga të cilat rreth 12 ECTS në kategorinë e lëndëve bazë (A); rreth 66 ECTS në kategorinë e disiplinave lëndëve karakterizuese (B); rreth 18 ECTS në kategorinë ndërdisiplinore/ integrale /me zgjedhje (C); rreth 12 ECTS në kategorinë plotësuese (D); rreth 12 ECTS në detyrimet përmbyllëse (E).



Në tabelat vijuese jepet struktura bazë e secilit profil.

Kategoria	Tipi i veprimtarisë dhe kategoria përkatëse	Nr.	Fushat disiplinore apo veprimtari të tjera	Kreditet lendeve	Kodet e lendeve
A	<i>Lëndë Bazë (Kategoria A) 5%-10% (ECTS)</i>	1	E Drejtë Biznesi	6	MSHDA1
		2	Shkrim Ligjor dhe Hartim Kontratash	6	MSHDA2
		Kreditet për t'u plotësuar nga studenti në këtë kategori janë 6 deri në 12 ECTS		12	
B	<i>Lëndë Karakterizuese (Kategoria B) 50%-60% (ECTS)</i>	1	E Drejtë Fiskale e krahasuar	6	MSHDB1
		2	Metodat e Kërkimit (I+II)	12	MSHDB2
		3	E Drejtë Bankare	6	MSHDB3
		4	E Drejtë e Konkurrencës dhe Antitrust	6	MSHDB4
		5	E Drejtë e Pronësisë Intelektuale	6	MSHDB5
		6	E Drejtë Ndërkombëtare Private	6	MSHDB6
		7	Gjykimi Administrativ	6	MSHDB7
		8	Alternativa e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjes	6	MSHDB8
		9	E Drejtë Europiane Private	6	MSHDB9
		10	E Drejtë Tregtare Europiane	6	MSHDB10
		Kreditet për t'u plotësuar nga studenti në këtë kategori janë 60 deri në 72 ECTS		66	
C	<i>Lëndë Ndërdisciplinore/ Integruese/ me zgjedhje (Kategoria C) 12%-20% (ECTS)*</i>	1	Sjellje Organizative dhe Lidership	6	MSHDC1
		Lëndë me zgjedhje			
		2	Rregullimi i Tregut të Energjisë dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm	6	MSHDC2
		3	E drejte ndërkombëtare publike	6	MSHDC3
		4	E Drejtë e Falimentit	6	MSHDC4
		5	E Drejtë Administrative Europiane	6	MSHDC5
		6	Siguria në Biznes dhe Shërbimet e Sigurisë	6	MSHDC6
		7	Mjedisi Rregullator i Biznesit	6	MSHDC7
		8	E Drejtë e Konsumatorit dhe Siguria e Produkteve	6	MSHDC8
Kreditet për t'u plotësuar nga studenti në këtë kategori janë 14 deri në 24 ECTS		18			
D	<i>Lëndë Plotësuese (Kategoria D) 10 % (ECTS)</i>	1	Zhvillim Personal dhe Komunikim Ndërpersonal	5	MSHDD1
		2	Praktikë Profesionale	7	MSHDD2
		Kreditet për t'u plotësuar nga studenti në këtë kategori janë 12		12	
E	<i>Detyrime Përmbyllëse (Simboli E)</i>	1	Temë Diplomë	12	MSHDE1

	10%-15% (ECTS)				
			Kreditet për t'u plotësuar nga studenti në këtë kategori janë 12 ECTS	12	
			Kreditet minimale për t'u plotësuar nga studenti 120 ECTS		

Neni 6

Lëndët bazë dhe me zgjedhje

- Numri i veprimtarive formuese është 12 ku janë parashikuar 10 lëndë (dhe provime), si edhe praktika profesionale, gjithashtu edhe tema e diplomës.
- Lëndët janë ndarë në katër grupe kryesore: (A) lëndë baze - 1 lende; (B) lëndë karakterizuese te programit dhe te profilit - 5 lëndë; (C) lëndë ndërdisiplinore/integruese - 3 lëndë; (D) praktika profesionale; (E) detyrime përmbyllëse, dorëzimi dhe mbrojtja e Temës së Diplomës.

Neni 7

Plani mësimor

Plani mësimor indikativ pasqyron periudhën kohore të organizimit të secilës disiplinë dhe veprimtari formuese të programit, ngarkesën e tyre në ECTS, orë në auditor dhe orë pune individuale të ndara në semestra, është dhënë në Aneksin A për këtë programi studimi.

Neni 8

Fleksibiliteti i Strukturës dhe planeve mësimore

Plani mësimor i paraqitur në nenin 7 më sipër, mund të përshtaten çdo vit akademik në përputhje me propozimet e njësive baze dhe aprovohen nga Rektori. Gjithashtu, ky plan mësimor përshtatet edhe në përputhje me nenet 6, 7, 12 dhe 32 të Rregullores për Programet Studimit dhe Procesin Mësimor.

Neni 9

Praktikat mësimore

Organizimi dhe zhvillimi i trajnimit praktik bëhet sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren e përgjithshme të TBU-së dhe Rregulloren për Praktikën Mësimore.

Neni 10

Kontrolli i dijes dhe sistemi i vlerësimit

Rregullat për zhvillimin e procesit mësimor, kontrollin e dijes dhe sistemin e vlerësimit janë të

përcaktuara me detaje ne nenet 14-23 te Rregullores për Programet e Studimit dhe Procesin Mësimor.

KREU III
PRANIMI I STUDENTËVE DHE AFATET E
STUDIMIT

Neni 11

Kriteret dhe Procedura e Pranimit të Studentëve

- a) Programi i studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave "E Drejtë Biznesi", është program i hapur për të gjithë ata studentë që zotërojnë diplomë Bachelor të shoqëruar me suplementin e diplomës, shqiptare ose te huaj, sipas standardit dhe rregullave të vendosura nga MAS, si dhe për studentët me transferim.
- b) Përpara fillimit të regjistrimeve të çdo viti akademik Njësiti Baze përgjegjëse për Programin e Studimit përcaktojnë edhe kriteret veçanta të cilat miratohen nga Rektori i TBU.

Neni 12

Afati i studimeve

- a) Kohëzgjatja normale e studimeve në programin e studimit Master i Shkencave "E Drejtë Biznesi" është 2 vite akademike.
- b) Në çdo rast studenti nuk mund të zgjasë studimet përtej dyfishit të afatit zyrtar të programit të studimit përveç rasteve kur ai ka pezulluar studimet ashtu si përcaktohet në Rregulloren e Përgjithshme të TBU.

KREU IV

VLERËSIMI ME KREDITE

Neni 13

Kreditet dhe llogaritja e tij

Kreditet për çdo modul përcaktojnë ngarkesën në orë mësimore në auditor si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara nga programi. Në tabelën më poshtë është dhënë ndarja në orë në auditor dhe orë pune individuale, që është përdorur si rregull për çdo një kredit për këtë program studimi.

1 kredit (ECTS) = 25 orë punë në total
Orë në auditor = rreth 10 orë
Orë punë individuale = rreth 15 orë

(Detyra shtëpie, Punë në grup, Provime të pjesshëm, Provimi final)

KREU V
VLERËSIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT

Neni 14
Sigurimi dhe vlerësimi i cilësisë

- a) Rezultatet dhe niveli cilësor i aktiviteteve formuese të zhvilluara në programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave "E Drejtë Biznesi" vlerësohen çdo vit në përfundim të programit nga Njësia e Brendshme e Vlerësimit të Cilësisë.
- b) Vlerësimi shërben si bazë për vazhdimësinë e programit të studimit dhe përmirësimin e tij në vite.
- c) Grupi i vlerësimit të brendshëm në bashkëpunim me zyrën e sigurimit të cilësisë mbledh të gjithë informacionin për përgatitjen e raportit të vlerësimit të brendshëm.

KREU VI
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 15

- a) Kjo rregullore mund të përsoset e korrigohet në përputhje me zhvillimet dhe detyrat e reja që merr përsipër programi Master i Shkencave "E Drejtë Biznesi".
- b) Të drejtën e interpretimit të kësaj Rregulloreje e ka Dekani i Fakultetit të Drejtësisë dhe Rektori.


Miratuar
Senati Akademik nr. 5/1, date 05.11.2019

Rektor
Prof. Dr. Ilia Kristo



Aneksi A

PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT MASTER I SHKENCAVE "E DREJTË BIZNESI" ME 120 ECTS											
SEMESTRI	Nr.	Lendet	Kategoria e vep. formuese	ECTS	Leksione	Seminare	Jave gjithsej	Gjithsej Leksione	Gjithsej Seminare	Total ore ne auditor	Orë pune individuale
SEMESTRI I	1	E DREJTË BIZNESI	A	6	2	2	15	30	30	60	90
	2	SHKRIM LIGJOR DHE HARTIM KONTRATASH	A	6	2	2	15	30	30	60	90
	3	METODAT E KËRKIMIT I	B	6	2	2	15	30	30	60	90
	4	E DREJTË FISKALE E KRAHASUAR	B	6	2	2	15	30	30	60	90
	5	E DREJTË E PRONËSISE INTELEKTUALE	B	6	2	2	15	30	30	60	90
Total semestri I				30	10	10	75	150	150	300	450
SEMESTRI II	6	METODAT E KËRKIMIT II	B	6	2	2	15	30	30	60	90
	7	E DREJTË E KONKURENCËS DHE ANTITRUST	B	6	2	2	15	30	30	60	90
	8	GJYKIMI ADMINISTRATIV	B	6	2	2	15	30	30	60	90
	9	E DREJTE EUROPIANE PRIVATE	B	6	2	2	15	30	30	60	90
	10	ALTERNATIVA E ZGJIDHJES SË MOSMARRËVESHJES	B	6	2	2	15	30	30	60	90
Total Semestri II				30	10	10	75	150	150	300	450



Total Vitit I		60	20	20	150	300	300	600	900	
SEMESTRI III	1	E DREJTË NDERKOMBËTARE PRIVATE	B	6	2	2	15	30	60	90
	2	E DREJTE TREGTARE EUROPIANE	B	6	2	2	15	30	60	90
	3	E DREJTE BANKARE	B	6	2	2	15	30	60	90
SEMESTRI III	4	SJELLJE ORGANIZATIVE DHE LIDERSHIP	C	6	2	2	15	30	60	90
	5	LËNDË ME ZGJEDHJE NR.1	C	6	2	2	15	30	60	90
Total semestri III		30	10	10	75	150	150	300	450	
SEMESTRI IV	6	LËNDË ME ZGJEDHJE NR.2	C	6	2	2	15	30	60	90
	7	PRAKTIKË PROFESIONALE	D	7						175
	8	ZHVILLIM PERSONAL DHE KOMUNIKIM NDERPERSONAL	D	5	2	1	15	30	45	80
SEMESTRI IV	9	TEME DIPLOME	E	12						300
	Total semestri IV		30	4	3	30	60	45	105	645
Total Vitit II		60	14	13	105	210	195	405	1095	
TOTAL Programi Master i Shkencave në E Drejtë Biznesi		120								

Miratoj
Rektori
Prof. Dr. Ilija Kristo




Dekani i Fakultetit të Drejtësisë
Prof. Asoc. Endri Papajorgji

Faqja 8 nga 8